


90 vite të bekuara!



Jeta është dhurata më e madhe që Zoti i ofron çdo qenieje njerëzore, por jo të gjithë e vlerësojnë dhe e përmbushin jetën e tyre. Një nga këta personalitete që e ka vlerësuar jetën edhe e ka përmbushur dhe vazhdon ta përmbushë atë me fjalë edhe punë të mira, është edhe Kryepiskopi i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumturia e tij, Anastas Janullatos.

Ai lindi në Pire më 4 nëntor të vitit 1929. Prindrit e tij ishin i ati Jerasimos Janullatos dhe e ëma Roksani Malltezi. Vitet e fëmijërisë edhe rinisë i kaloi në një periudhë të vështirë ku Europa edhe Ballkani sapo dolën nga lufta e parë, hynë në një tjetër luftë të dytë më mizore se para, që u mori jetën shumë të pafajshmëve, dhe ringjalli ndjenjat më primitive mes njerëzve, duke lënë pas vetëm shkatrim qytetërimesh. Megjithatë, edhe pse koha ishte e egër, përsëri shpirti i tij mbeti i butë dhe plot besim dhe dashuri për Zotin, që e drejtonte në dashuri për të afërmin, të krijuar sipas ikonës së Zotit: “Sepse dashuria është nga Perëndia dhe kush do, ka lindur nga Perëndia dhe e njeh Perëndinë” (I Joanit 4 -7)

Tek ky njeri janë kombinuar në mënyrë të veçantë një shpirt i madh dhe një inteligjencë tepër e lartë. Etja e tij e pashuar për dituri e çoi atë drejt një përkushtimi të plot ndaj Zotit Jisu Krishtit, Birit të Njeriut: “Diturinë e Perëndisë” (I

Korintasve 1-24), sepse Solomoni i urtë (971-931 pr K) këshillonte: “Dituria është gjëja më e rëndësishme; prandaj fito diturinë. Edhe sikur të humbasësh ato që ke, fito diturinë. Përlëvdoje dhe ajo do të të lartësojë, ajo do të të japë lavdi, po qe se ti e përvetëson. Ajo do të të vërë mbi kokën tënde një stoli prej nuri, do të të rrethojë me një kurorë lavdie” (Fjalët e Urta 4:7-9).

Ai përfundoi shkëlqyeshëm studimet universitare me notën më të lartë dhe u bë Doktor i Fakultetit Teologjik të Universitetit të Athinës. Ka studiuar Fetarologji, Teologji Ekumenike dhe Etnologji në Universitetin e Hamburgut dhe të Marburgut në Gjermani me bursë pasuniversitare të Fondacionit “Alexander von Humboldt”. Ka studiuar Islamin, Budizmin, Taoizmin, Konfucizmin dhe besime fetare afrikane në vendet ku ato ekzistojnë në Indi, Tajlandë, Srilanka, Kore, Japoni, Kinë, Kenia, Uganda, Tanzani, Nigeri, Meksikë dhe Karaibe.

Profesor Doktor Anastasi ka qenë Pedagog i Historisë së Feve në Universitetin Kombëtar Kapodistrian të Athinës gjatë viteve 1972-1997, Dekan i Fakultetit të Teologjisë 1982-1996 dhe Anëtar Korespondent i Akademisë së Athinës (1993-2005). Që nga 1991 dhe deri më sot është Profesor Emeritus i Universitetit të Athinës dhe Anëtar Nderi i Akademisë së Athinës që prej 2006.

Gjithashtu ai është shpallur Doktor Nderi i Teologjisë dhe Doktor Nderi i Filozofisë i 17 Universiteteve, Fakulteteve, ose Degëve Universitare, si në (Greqi, SHBA, Rumani, Qipro, Gjeorgji, Shqipëri, Itali). Flet anglisht, gjermanisht, frëngjisht, lexon latinisht, italisht, spanjisht dhe shqip.

Është autor i dhjetëra monografive shkencore dhe mbi 240 studimeve dhe artikujve me përmbajtje teologjike ose fetarologjike, studime dhe artikuj që janë përkthyer në 12 gjuhë të huaja. Ka mbajtur ligjërata në forume ndërkombëtare, lidhur me dëshminë e sotme të krishterë, dialogun ndërfetar, solidaritetin dhe paqen botërore.

Në vitin 1960 u përkushtua totalisht misionit hieratik dhe u hirotonis hierodhjakon dhe në vitin 1964 prift. Në vitin 1972 u hirotonis episkop (i Andrusës) duke pasur përgjegjësinë e Drejtorit të Shërbimit Apostolik të Kishës së Greqisë (1971-1972).

Duke kuptuar qartë urdhërin e Krishtit të thënë nxënësve të Tij në çdo kohë: “Dilni në mbarë botën dhe i predikoni ungjillin çdo krijese” (Mk. 16:15), çeli rrugën për ringjalljen e dëshmisë orthodhokse në botë në ditët e sotme. Ka punuar për një dhjetëvjeçar (1964, 1981, 1990) për ngritjen e kishave të reja lokale në Afrikë, si mbikqyrës i Mitropolisë së Irinupolit, në Kenia, Tanzani dhe Ugandë. Për periudhën 1981-1990 ka zhvilluar një veprimtari të gjerë hierapostolike dhe sociale. Për këtë u nderua me dekoratën Bamirësi i Madh i Patriarkanës së Aleksandrisë 2009.

Episkopi i Andrusës, Anastasi, që ishte me shërbim hierapostolik në Afrikën Lindore, në janar të vitit 1991, zgjidhet nga Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike si eksark patriarkal, për të ardhur në Shqipërinë post-ateist-komuniste, për të parë çfarë kishte mbetur nga persekutimi që kishte provuar Kisha Ortodhokse Autoqefale në Shqipëri, e izoluar prej 40 vjetësh nga kishat e tjera si motra. Ai erdhi në Shqipëri në 17 korrik 1991 dhe u prit me mallëngjim nga një grup i vogël besimtarësh. Duke udhëtuar në mbarë Shqipërinë konstatoi shkatërrimin e frikshëm dhe shpërbërjen e plotë të Kishës Ortodhokse në Shqipëri. Pothuajse nga tri episkopatat, 19 zëvendësitë arhieratike, 330 enoritë dhe 25 manastiret që kishte Kisha në administrim para 1967, nuk kishte mbetur asgjë, pasuritë kishtarë ishin të konfiskuara, kishat të transformuara në depo, stalla, reparte ushtarake, shtëpi kulture dhe nga të gjithë klerikët, kishin mbetur vetëm 12 priftërinj, tre dhjakonë, asnjë episkop, ku shumica ishin të sëmurë dhe në moshë të thyer.

Orthodhoksët e Shqipërisë kërkuan që eksarku patriarkal të qëndronte në Shqipëri dhe të merrte përsipër veprën e ringritjes së Kishës, sepse nuk u gjend asnjë person klerik, ose laik i formuar me arsimin e përshtatshëm dhe i pamartuar me nënshtetësi shqiptare për të marrë barrën e madhe të ringritjes nga themelet së Kishës Ortodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Më 24 qershor 1992, me propozim të Patriarkut Ekumenik, Vartholomeu I, eksarku Patriarkal Anastas Janullatos, u zgjodh me vota unanime Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë. Zgjedhja e Kryepiskopit më 24 qershor 1992 ishte sipas rregullave të orthodhoksisë dhe ishte një fakt i kryer kishtar. Ky akt u bë i ditur me letra zyrtare patriarkale të gjithë Kishave Orthodhokse në botë. Fronëzimi i tij u krye në kishën e Ungjillëzimit në Tiranë në 2 Gusht 1992.

Ai erdhi në Shqipëri në moshën 62 vjeçare dhe për 28 vite deri më sot, së bashku me bashkëpunëtorët klerikë dhe laikë vendas edhe të huaj, me hirin e Perëndisë e ringjalli Kishën e shkatërruar deri në themel. Përgjatë këtyre viteve u riorganizuan 460 enori orthodhokse në qytete e fshatra ku zhvillohen veprimtari liturgjike predikuese e katekiste. Janë ndërtuar mbi 150 Kisha të reja, të vogla, të mëdha

edhe katedrale madhështore në shumë qytete të Shqipërisë, janë restauruar 60 kisha, manastire, monumente kulture, janë riparuar 160 kisha, janë blerë dhe rikonstruktuar më shumë se 70 godina për kopshte, shkolla, qendra rinore, qendra shëndetësore, selitë mitropolitane, shtëpi pritje, punishte, mensa për të varfërit, e tërë vepra ndërtuese arrin mbi 450 objekte, po ashtu ndërtimi i hidroçentralit HEC Rapuni 3&4 (Librazhd), 2016.

Me kujdesin e Kryepiskopit Anastas u arsimua një brez i ri klerikësh nënshtetas shqiptarë, në Akademinë Teologjike “Ngjallja e Krishtit” – Shën Vlash Durrës, sot degë e Teologjisë në Kolegjin Universitar “Logos”. Gjithsej janë hirotonisur dhe shërbejnë 159 klerikë të të gjitha gradave klerikale, si dhjakon, prift, episkop në gjashtë mitropoli.

Sipas vizionit të tij që: “Rinia nuk është vetëm e ardhmja, por edhe e tashmja,” u krijuan dhe funksionojnë 50 qendra rinore në qytete e fshatra. Çdo vit organizohen veprimtari rinore të larmishme si kampingjet verore, konferenca, veprimtari sportive, aktivitete me të rinj me aftësi të kufizuara, festivale rinore etj.

Janë ndërtuar nga themelet katër shkolla me konvikte, si shkolla e mesme kishtare me emrin “Kryqi i nderuar” në Gjirokastrë. Gjithashtu janë ngritur dhe funksionojnë 19 kopshte në Tiranë, Durrës, Kavajë, Korçë, Lushnjë, Elbasan, Cerrik, Gramsh etj. Në Tiranë funksionon kompleksi arsimor shqiptaro-amerikan me emrin “Protagonistët”, po ashtu dhe në Durrës dhe në Gjirokastrë shkolla 9-vjeçare “Frymë Dashurie”. Në Korçë funksionon që prej vitit 2013 shkolla e mesme “Platoni”, në Mesopotam në Sarandë funksionon shkolla e mesme teknike “Apostull Pavli”. Në Tiranë dhe Gjirokastrë funksionon Instituti i Formimit Profesional “Frymë Dashurie”. Tetorin të vitit 2012 u hap në qendrën Tabor shkolla e parë e Muzikës Bizantine me konvikt. Në Tiranë funksionon Kolegji Universitar “Logos”.

Janë botuar me dhjetëra libra teologjikë dhe formues, botohet periodikisht gazeta “Ngjallja”, revista për fëmijë “Gëzohu”, revista rinore “Kambanat”, revista “Kërkim”, të cilat formojnë breza të çdo moshe me vlera morale, me dashuri pa interes, me ndjenjën e sakrificës për të mirën, të respektit të lirisë së tjetrit, të bashkëjetesës, për t’u bërë njerëz të moralshëm dhe qytetarë të vërtetë.

Me bekimin edhe mbështetjen e tij prej vitesh një Zyrë e veçantë e Trashëgimisë Kulturore merret me objektet orthodhokse të kultit që janë dhe monumente të kulturës sonë kombëtare, për riparimin e të cilave janë përdorur me dhjetëra miliona euro. Janë ngritur studio për pikturimin dhe restaurimin e ikonave. Deri sot janë restauruar rreth 600 ikona. U përgatit një brez i ri artistësh që po rigjallërojnë traditën tonë të pasur ikonografike. Ky është një kontribut i jashtëzakonshëm për

ruajtjen dhe promovimin e vlerave të pallogaritshme të artit ikonografik me autorë shqiptarë si Onufri, Kostandin Shpataraku etj.

Nga viti 1998 transmeton stacioni radiofonik “Ngjallja” me frekuencë FM 88.5 Mhz për Tiranën dhe Durrësin, 93.4 Mhz në Elbasan, 98.7 Mhz në Fier dhe 88.7 Mhz në Korçë. Ajo transmeton 24 orë programe shpirtërore, kulturore, sociale, historike, muzikë kishtare, popullore e klasike si edhe shërbesa kishtare.

Po ashtu prej 20 vitesh funksionon Qendra mjekësore diagnostikuese “Ungjillëzimi” në Tiranë, me 23 specialitete, e cila ofron shërbime bashkëkohore mjekësore, së bashku me qendra të kujdesit shëndetësor që funksionojnë edhe në vende të tjera si Korçë, Kavajë dhe Gjirokastër. Në mjediset e manastirit të Shën Vlashit funksionon Shtëpia e Fëmijëve Shpresa. Në vitin 2018 filloi të funksionojë shtëpia e të moshuarave: Familja e Dashurisë “Hyjlindësja Mari”.

Gjatë krizave të ndryshme që ka kaluar vendi ynë 1992, 1994, 1997 Kisha Orthodhokse, e udhëhequr nga kryepiskopi Anastas, ka zhvilluar një veprimtari të gjerë sociale e humanitare duke siguruar e shpërndarë mijëra ton ushqime, veshmbathje dhe ilaçe. Me iniciativën dhe kujdesin e vazhdueshëm të tij, Kisha Orthodhokse ka mbështetur një numër të madh programesh sociale, ku përfshihen projekte zhvillimi për zonat malore, për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, ndërtim rrugësh e ujësjellësash, programe për edukimin shëndetësor të fëmijëve dhe grave. Ngritja e qendrave shëndetësore në fshatra, kontribute për shkolla (Gërdec), jetimore (Zyber Hallulli), spitale, burgje (burgu 325: sera, fusha e sportit), ndihma për Institutet dhe personat me aftësi të kufizuara, azile, të burgosurit, dreka për të varfrit (Tiranë, Korçë, Berat) etj.

Në vitin 1999 kur në Shqipëri mbërritën mijëra refugjatë nga Kosova, Kisha Orthodhokse në bashkëpunim me Kishat e tjera në Europë, ndihmoi dhe strehoi 33 mijë refugjatë. Në vitin 2008 pas tragjedisë në fshatin Gërdec, Kisha me bekimin e kryepiskopit, ka kontribuar në ndihmë të të dëmtuarve. Ndihma monetare janë shpërndarë edhe për familjet e prekura nga përmbytjet në zonat e veriut.

Është për t'u theksuar dhe i njohur botërisht kontributi i tij në fushën e shkencës së teologjisë dhe dëshmisë së krishterë bashkëkohore, në përafrimin me konfesionet e tjera të krishtera si katolikët, protestantët, në dialogun ndërfaqësor dhe bashkë ekzistencën paqësore midis popujve dhe feve.

Nëpërmjet personalitetit dhe kontributit të tij panorthodhoks dhe ndërkombëtar, Kisha Orthodhokse e Shqipërisë merr pjesë në të gjitha veprimtaritë e Kishave Orthodhokse në mbarë botën dhe është anëtare e Konferencës Europiane të

Kishave, anëtare e Këshillit Botëror të Kishave. Pjesëmarrja e Kryepiskopit Anastas si primat i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë në këto evente ndërkombëtare, është një e mirë jo vetëm për Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, por për të gjithë vendin dhe shqiptarët që aspirojnë prej vitesh të bëhen pjesë e Bashkimit European.

Një kontribut tjetër i madh i Kryepiskopit Anastas është ndikimi i tij i padiskutueshëm si njeri i dashurisë, i së vërtetës dhe i paqes duke ndikuar ndjeshëm për uljen e tensioneve midis shteteve, grupeve etnike dhe komuniteteve fetare. Në vitin 2000, me propozimin e 33 akademikëve nga Akademia e Athinës dhe të shumë personaliteteve të Shqipërisë, ka qenë kandidat për çmimin Nobel për paqen. Ai është zgjedhur vazhdimisht në pozicione të shquara të organizmave ndërkombëtare, President i Komitetit të Dëshmisë dhe Ungjillëzimit Botëror pranë Këshillit Botëror të Kishave 1989 dhe Zëvendës President i Konferencës së Kishave Evropiane 2003-2009.

Nga viti 2009 është President Nderi i Konferencës Botërore “Fetë për Paqen”, ka marrë shumë çmime, dekorata për paqen, si ajo që mori në Moskë në 2006 “Për kontributin e shquar për Paqen, Dialogun dhe Mirëkuptimin”. Për këtë kontribut është nderuar edhe nga Republika e Shqipërisë me dekoratën “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, në 2010-en, dhe në dhjetor të vitit 2017 mori më në fund nështetësinë shqiptare.

Sipas psalmistit: “Ditët e viteve tona shkojnë deri në shtatëdhjetë vjet dhe për të fortët në tetëdhjetë” (Psalmi 90- 10), por ai me hirin e Zotit, e tejkaloi këtë limit edhe më 4 nëntor mbush 90 vjeç. Pavarësisht moshës ai është një njeri vital që me shpirt të ri vrapon me vizion largpamës për të ndërtuar vepra sa më të mëdha për lavdin e Zotit, për të mirën e Kishës dhe besimtarëve orthodhoksë, të shqiptarëve edhe të vendit tonë.

Ai në këtë moshë gjëndet në një dilemë ashtu si apostulli Pavli që predikoj nga Jerusalemi deri në Ilirik: “Sepse për mua të jetuarit është Krishti dhe të vdekurit fitim. Por nuk e di se jeta në mish të jetë për mua një punë e frytshme, as mund të them çfarë duhej të zgjedh, sepse unë jam i shtrënguar nga dy anë, sepse kam dëshirë të iki nga kjo çadër dhe të jem bashkë me Krishtin, gjëja më e mirë, por të qëndruarit në mish është më i nevojshëm për ju. Këtë e di me siguri, që do të ri dhe do të qëndroj me ju të gjithë për përparimin tuaj dhe për gëzimin e besimit tuaj, që mburja juaj për mua të teprojë në Jisu Krishtin, për praninë time sërish midis jush” (Filipianve 1:21-24).

Për shumë vjet o Kryezot!

Nga Miron Çako, përgjegjësi i Zyrës së Katekizmit të Kryepiskopatës, KOASH.

— cna.al